



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 53/1 Prot.

Tiranë, më 16.1.2024

VENDIM
Nr. 4, datë 16.1.2024

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 82, DATË 23.10.2023

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit nr. 82, datë 23.10.2023, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë gjatë aplikimit të masës disiplinore, largim nga shërbimi civil dhe paralajmërimin e institucionit të Bashkisë Vlorë për të rregulluar paligjshmërinë e konstatuar”.

KONSTATOVA SE:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është regjistruar informacioni me nr. 454 prot., datë 4.5.2023, përmes të cilit ngrihen pretendime se nuk janë respektuar rregullat e legjislacionit të shërbimit civil, gjatë procedurës së dhënies së masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, në ngarkim të nëpunësit ***** , me detyrë “Specialist Arkitekt”, në Drejtorinë e Urbanistikës, pranë Bashkisë Vlorë.

Pas shqyrtimit të të dhënave që përmbante informacioni i përcjellë, Komisioneri ka kryer hetimin administrativ mbi çështjen në fjalë.

Ky proces është përmbyllur me vendimin nr. 82, datë 23.10. 2023, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë gjatë aplikimit të masës disiplinore, largim nga shërbimi civil dhe paralajmërimin e institucionit të Bashkisë Vlorë për të rregulluar paligjshmërinë e konstatuar”.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Vlorë, me shkresën nr. 12938/1 prot., datë 22.12.2023, ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin dhe në pjesën arsyetuese të vendimit paralajmërues, duke bashkëngjitur dokumentacionin që provon zbatimin e tij.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr. 82, datë 23.10. 2023, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse, situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin e mbikëqyrur paraqitet si më poshtë vijon:

Konkretisht, Komisioneri në pikën 1 të dispozitivit të vendimit objekt i hetimit administrativ, ka kërkuar nga Kryetari i Bashkisë Vlorë të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit nr. 26, datë 23.3.2023, *“Për largimin nga detyra”*, të nëpunësit *****, duke urdhëruar rikthimin në pozicionin e tij të punës si *“Specialist Arkitekt”* në Drejtorinë e Urbanistikës, në Bashkinë Vlorë si dhe rregullimin e pasojave që kanë ardhur në këtë rast. Në pikën 2 të këtij vendimi është kërkuar konstatimi i pavlefshmërisë absolute të aktit nr. 3, datë 22.4.2022, për pezullimin nga detyra të këtij nëpunësi.

Konstatoj se, Bashkia Vlorë, me Akt-Anulim pezullimi nr. 140 dhe Vendimin nr. 139, datë 16.11.2023, ka urdhëruar respektivisht anulimin e aktit nr. 3, datë 22.4.2022, *“Për pezullimin nga shërbimi civil në Bashkinë Vlorë”*, për ***** dhe anulimin e aktit nr.26, datë 23.3.2023, *“Për largim nga detyra”*, për këtë nëpunës, si dhe kryerjen e pagesave sipas urdhërimit të Komisionerit.

Sa më sipër, çmoj se nga ana e institucionit objekt i mbikëqyrjes në vazhdim, janë zbatuar detyrat e lëna në vendimin paralajmërues nr. 82, datë 23.10.2023 të institucionit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 82, datë 23.10. 2023, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë gjatë aplikimit të masës disiplinore, largim nga shërbimi civil dhe paralajmërimit e institucionit të Bashkisë Vlorë për të rregulluar paligjshmërinë e konstatuar”*.

2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Bashkia Vlorë, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit nr. 82, datë 23.10. 2023.
3. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Vlorë dhe nëpunësi *****.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha